



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, datë 22.06.2020

NJOFTIM PËR SHTYP

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural më datë 19.06.2020, ora 24:00 mbylli aplikimet për Skemën Kombëtare të Mbështetjes për fermerët. Fondi mbështetës që iu vjen në ndihmë fermerëve për vitin 2020 është 743,900,000 lekë, ndërkohë në total janë vlerësuar si aplikime të rregullta 7653 fermerë dhe kjo konsiderohet si një nga shifrat më të larta që AZHBR ka administruar ndonjëherë gjatë këtyre viteve.

Me përfundimin e kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen online, AZHBR shpall brenda **10 ditëve pune**, listën e aplikimeve të kualifikuara me vizën e financimit dhe dokumentet plotësuese, sipas masës përkatëse, në faqen zyrtare të saj: www.azhbr.gov.al.

Të gjithë aplikantët mbi vijën e financimit, përfshirë edhe ata me mangësi në aplikim, sipas evidentimeve në listat e shpallura, kanë afat deri më **17.07.2020**, të dorëzojnë dokumentet e kërkuara në Agropikën më të afërt, në zyrat qendrore të AZHBR-së ose me postë në adresën: Rruga “Muhamet Gjollesha”, nr.56, Tiranë.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL